



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**Nr. 473**  
**Dt. 30.12.2015**  
**Prishtinë**

**DREJTORIA E ARSIMIT**  
**SQARIM PËR TË GJITHË KANDIDATËT**

Të nderuar kandidatë,

Komisionet përkatëse të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) të Komunës së Prishtinës, të mërkurën, më 30 dhjetor 2015, kanë bërë përzgjedhjen e kandidatëve për intervistim, të cilët kanë aplikuar sipas konkursit të datës 26.11.2014 dhe vazhdimin të tij sipas njoftimit Nr. 472, dt. 22.12.2015.

Përzgjedhja është bërë në monitorimin e shoqërisë civile dhe sipas procedurës së përzgjedhjes, kritereve të paraseleksionimit dhe udhëzimeve administrative përkatëse, dokumente të cilat kanë qenë publike për të gjithë kandidatët dhe janë në dispozicion të të gjithë kandidatëve edhe këtu në ueb faqe.

Për të qenë plotësisht transparent, DKA publikon edhe databazën e kandidatëve, në mënyrë që secili mund të shoh se kush është përzgjedhur për intervistim e kush jo.

Databaza ka të dhënat e kandidatëve që kanë aplikuar në pozitat sipas konkursit të shpallur prej 1-56. Në aplikacione ka pasur disa kandidatë që nuk kanë dëshmuar notën mesatare; që kanë poseduar certifikatë në vend të diplomës më tepër se gjashtë muaj nga data e diplomimit; që kanë poseduar diplomë të pa nostifikuar në MASHT, prandaj në mungesë të të dhënave sipas kushteve të konkursit aplikacionet e tyre nuk janë shqyrtuar.

Me vendimin nr. 453, dt. 26.11.2015 është anuluar kodi 30; (shih linkun me poshtë)

<http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/aa4cf7a0-daf7-4d57-bcca-097dd1e52ca2/Anulim-i-pozites-se-konkursit-te-jashtezakonshem-t.aspx>

Me vendimin nr. 454, dt. 01.12.2015 është anuluar kodi 29 dhe 41, si dhe janë ndryshuar kodet 37, 21, 38 dhe 49 (shih linkun me poshtë)

[http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/f6c468b8-7977-43cb-b9ef-c0beaf352977/Anulim-i-pozites-se-konkursit-te-jashtezakonsh-\(1\).aspx](http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/f6c468b8-7977-43cb-b9ef-c0beaf352977/Anulim-i-pozites-se-konkursit-te-jashtezakonsh-(1).aspx)

Për shkak të mungesës së kandidateve me kualifikime përkatëse sipas udhëzimeve administrative të MASHT-it, anulohen këto kode: 6, 26, 34, 44, dhe 45.

Për secilën pozitë (kodi i pozitës sipas konkursit) të dhënat gjenden në databaza (në sheets sipas kodit).

- Fillimisht janë marrë në konsideratë vetëm kandidatët e rangut të parë sipas Udhëzimeve Administrativ (UA) dhe nëse ka pasur kandidatë të mjaftueshëm të kësaj kategorie, atëherë kandidatët e rangut tjetër nuk janë marrë parasysh.

- Kandidatët që kanë pasur më shumë vite të studimeve dhe ECTS kredi, janë marrë parasysh para kandidatëve të tjerë.

- Kandidatët që janë të hijezuar me ngjyrë të kuqe janë kandidatë që kanë qenë të kualifikuar si kandidatë të rangut të parë sipas Udhëzimeve Administrative, të cilët kanë arritur të përzgjidhen për intervistim, më së shumti pikë.

- Kandidatët që janë të hijezuar me ngjyrë të kaltër janë kandidatë që janë përzgjedhur për t'u intervistuar në ndonjë pozitë tjetër, meqë kanë aplikuar në më shumë se një pozitë, në ndërkohë që mund të ftohet në vetëm një vend/pozitë për intervistim.

Për të ruajtur konfidencialitetin e kandidatëve, nëpër databaza janë vetëm emrat e mbiemrat e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistim, ndërsa për kandidatët e tjerë janë vetëm numrat e protokollit, në mënyrë që secili të mund t'i shoh pikët e tij/saj në ndërkohë që të tjerët nuk mund të dinë identitetin e tyre.

Në DKA kanë arritur 2556 aplikime për konkurs dhe DKA inkurajon secilin aplikues që në rast ankese të drejtohen në Drejtorinë e Arsimit përkatësisht në zyrën nr. 77, nga data 31.12.2015 deri me 08.01.2016 ku do të bëhet intervenimi i menjëhershëm në përmirësimin e çdo lëshimit eventual.